



BRIO GROUP
logjistikë



**LOGJISTIKË ME RISI,
DEDIKIM E TEKNOLOGJI**

PROFIL


Brio Group lind në vitin 2006 falë iniciativës së disa kompanive të specializuara në kryerjen e aktiviteteve Global Service, në sajë të të cilave është në gjendje të realizojë projekte të avancuara në fushën e Shërbimeve Logjistike të Integruara.

Core business i saj është logjistika në outsourcing përmes administrimit të segmenteve të supply chain me avantazhe të çmuara përsa i takon efikasitetit, elasticitetit dhe shfrytëzimit të know-how, të teknologjive e të burimeve njerëzore të kualifikuara.

Është në gjendje t'u përshtatet ndryshimeve të tregut duke bërë të mundur që ato të mos çënojnë automatikisht cilësinë dhe pricing e shërbimit, e duke garantuar efikasitet në kryerjen e tij. Operon në makro-sektorët Food e No Food duke u ofruar Klientëve të saj shërbime të personalizuara përmes programimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të aktiviteteve të kërkuara. Dëshiron të jetë partneri logjistik në nivel kombëtar për të kënaqur tregun aktual të Klientëve, duke patur si mission pikërisht "total customer satisfaction".

Brio Group përdor një sistem administrimi në rrespektim të kritereve të përcaktuara nga norma ISO 9001:2008 për çertifikimin e shërbimeve sikurse vijon: logjistikë, transport, shërbim portieri e pastrimi, dhe rezulton e regjistruar në Rregjistrin kombëtar të Autotransportuesve me numrin BE/7463680/R. Zotëron një flotë mjetesh, që përdoret për aktivitetin e transportit, prej 10 kokash tërheqëse dhe 10 gjysëm-rimorkiosh, të kontrolluar nga punonjësit tepër të kualifikuar të Zyrës sonë të Trafikut.

Struktura organizative e Kompanisë



SHËRBIME

TRANSPORT





Lëvizim, transportojmë e dorëzojmë në afate të garantuara çdo lloj malli, në çdo vend të Italisë, pa kufizim peshe, dimensionesh, volumesh e numër kolish. Falë një network të përhapur, ofrojmë një shërbim të personalizuar, të karakterizuar nga një cilësi e lartë e aktiviteteve: tërheqje malli pranë qendrës së klientit, ruajtje në magazinat e saj, transport i përditshëm nga e drejt të gjitha rajoneve të Italisë, administrim i informatizuar i pagesave për transportin në dorëzim të mallit, mbikqyrje e vazhdueshme e dërgesave. Si përherë, vemë në dispozicion mjete dhe pajisje për të transportuar mallrat me përpikmëri, shpejtësi e siguri.

LOGJISTIKË

Falë një network logjistik të përhapur Brio Group është në gjendje të realizojë Projekte Administruese të Avancuara. Të planifikojë, të organizojë dhe të kontrollojë fluksin e mallrave nga vendi i origjinës në vendin e konsumimit është pikërisht ai mission që Brio Group ndjek. Shërbimi i lëvizjes së mallrave kryhet nga punonjës tepër të kualifikuar, me mjete të pajisura me teknologjitë më të përparuara. Know how i përfituar ndër vite, lejon që t'u ofrojë klientëve të saj, të cilët operojnë në sektorët Fashion, Automotive, Food e No Food, kushtet më të mira, si në aspektin organizativ ashtu edhe në atë ekonomik.



ADMINISTRIM SHËRBIMESH



Logjistika përmbledh tërësinë e operacioneve të orientuara drejt perfeksionimit të fluksit fizik të materialeve dhe atij të informacioneve të lidhura me to, që lind për efekt të aktivitetit të biznesit.

BRIO GROUP është në gjendje të administrojë më së miri fazat e ndryshme të aktivitetit duke i vënë vetes si objektiv tejkalimin e pritshmërive të Klientit.

BRIO GROUP ofron një gamë të gjerë shërbimesh taylor made, të realizuara bazuar në nevojat specifike të Klientit, përmes të cilave përfitohen një sërë avantazhesh konkrete përgjatë gjithë supply-chain.

Aktivitetet logjistike të ndërmarra në fillim të procesit prodhues (inbound ose edhe upstream logistics) lidhen me administrimin e furnizimeve të materialeve.

Aktivitetet logjistike të ndërmarra në përfundim të procesit prodhues (të quajtura edhe aktivitete outbound ose downstream logistics) lidhen me administrimin e flukseve të ruajtjes dhe shpërndarjes së produkteve të përfunduara.


BRIO GROUP ofrohet si operator i specializuar në sektorin e shërbimeve logjistike INBOUND e OUTBOUND



OPERATIONS

LOGJISTIKË INBOUND

- ✓ Zgjerim i sistemit informatik; Zgjidhje multi-Klient.
- ✓ Pranim dhe kontroll cilësie; Sistemime rendore dhe përcaktim lidhjeje me linja prodhimi.
- ✓ Planifikim dhe mbikqyrje e transporteve; Administrim fluksesh; Aplikim i sistemit të cilësisë mbi flukset e supply-chain.
- ✓ Administrim i qendrave të përforcimit, të platformave logjistike si dhe të qendrave të shpërndarjes.




LOGJISTIKË OUTBOUND

- ✓ Pranim dhe kontroll cilësie.
- ✓ Administrim barcode-sh dhe përdorim Radio-frekuence.
- ✓ Administrim CKD.

OPERATIONS

PARA-STOCK/PACKING

- ✓ Izolim dhe mbrojtje e produktit me blister, skin pack, plasmas gjysëm rezistent ndaj zjarrit, kuti, plasmas në forme rruli.
- ✓ Pack to order.
- ✓ Mënyra ruajtjeje të diferencuara.
- ✓ Magazinin materialesh të rrezikshme.
- ✓ Picking në sasi të mëdha/pick-pack/rendor.
- ✓ Picking sipas FiFo dhe LiFo.



DËRGIM

- ✓ Administrim dërgesash të kthyera mbrapsht.
- ✓ Administrim materiali për amballazh.
- ✓ Administrim furnitorësh.
- ✓ Administrim i furnizimeve.
- ✓ Mbikqyrje KPI furnitorësh.



www.consorziobrio.it



info@consorziobrio.it



via Vittor Pisani, 10, Milano (MI)



via Umbria, 7, Roma (RM)



Corso di Spagna, 21, Padova (PD)



prol. via Matarrese 264, Bari (BA)